
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Data: 02.06.2026

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE PAJISJESH FONIE, NDRIÇIMI, VIDEO DHE
EFEKTESH SKENIKE**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): *Ekran projektimi 38653400-1; Mikrofon dhe komplete folese 32342300-5; Mikrofon 32341000-5; Pajisje akustike 32342400-6*

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,220,489 (tre milion e dyqind e njetzet mijë e katerqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Bazuar në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohet 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Bazuar në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se: “ 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.*”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës e fondit limit të kontratës është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19%** e vlerës e fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose*

entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Bazuar në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi për të gjitha mallrat objekt prokurimi, ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të tyre, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e mallrave të ofruar me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”* dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: *“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”*. Me

anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Nisur nga lloji i mallit që kërkohet, të cilat janë të rëndësishme për punën e Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si katalog/ skedë teknike nga prodhuesi i mallit. Gjithashtu katalogët/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standartet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”* Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë" të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.* Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar/vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, ku të deklarojë se afati i garancisë së mallrave objekt prokurimi, do të jetë sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar në rastin konkret është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t’i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar pëson defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit/instalimit të tyre.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit dhe shërbime të lidhur me pajisjet, si instalimi, konfigurimi, vënia në punë e pasjisjeve dhe trajnimi i stafit që do të përdorë pajisjet, sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendndodhjen përkatëse të caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues, si dhe të sigurojë se do të kryejë instalimin, konfigurimin dhe trajnimin e stafit që do të përdorë pajisjet e ofruara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuar, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efijencën e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, si më poshtë:

Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, pasi siguroj kërkesat e institucionit mbi nevojat për pajisje fonie, ndriçimi video dhe efektsh skenike, sasinë e mallit që do t'i nënshtrohet procedurës së prokurimit, referuar nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me

kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e furnizimit që do të prokurohet. Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. Në specifikimet teknike nuk përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR ÇDO ARTIKULL

1. Videoprojektor – sasia 1

Videoprojektori duhet të jetë profesional për instalim fiks, pasi do të përdoret në ambient salle teatri dhe duhet të punojë në mënyrë të qëndrueshme. Teknologjia duhet të jetë 3LCD me MLA ose ekuivalente profesionale, për riprodhim të mirë të ngjyrave dhe figurë e qëndrueshme

Rezolucioni minimal duhet të jetë WUXGA 1920 × 1200, pasi nevojitet figurë e qartë për video, prezantime dhe përmbajtje grafike. Format i duhet 16:10 për përputhje me ekranin dhe për shfrytëzim më të mirë të sipërfaqes së projektimit. Ndriçimi duhet 8000 ANSI ose me mirë lumen është i nevojshëm për projektion të dukshëm në sipërfaqe të mëdha dhe ambiente me ndriçim të

pjeshëm. Kontrasti minimal 3,000,000:1 dinamik për thellësi më të mirë të figurës dhe dallim më të qartë të detajeve.

Jetëgjatësia deri në 30,000 orë për përdorim afatgjatë dhe ulje të kostove të mirëmbajtjes. Madhësia e imazhit deri në 300” është e nevojshme për përdorim në salla të mëdha. Throw ratio 1.2–2.0:1 ose zgjidhje ekuivalente për fleksibilitet në pozicionimin e projektorit sipas distancës reale. Zoom optik minimum 1.6×, lens shift vertikal +60%/0% dhe horizontal ±29% kërkohen që figura të rregullohet pa zhvendosur fizikisht pajisjen.

Sistemi duhet të ketë korrigjim gjeometrik horizontal dhe vertikal i cili nevojitet për të korrigjuar deformimet e figurës gjatë instalimit. Duhet të ketë video processing për përshtatje të sinjalit në rezolucionin natyral për cilësi më të mirë imazhi. Të ketë mbështetje për formate 16:10, 16:9 dhe 4:3 për materiale/formate të ndryshme video. Duhet të ketë EDID dhe sinkronizim të sinjalit të cilët nevojiten për komunikim të saktë me burimet video.

Sistemi i projektimit duhet të ketë minimum 3 hyrje HDMI, pasi nëpër shfaqje mund të nevojiten disa burime video. Të paktën 1xHyrje VGA për pajisje ekzistuese më të vjetra. 1xAudio in dhe out për integrim me sistemin audio. 1xUSB Type-A për lidhjen e pajisjeve ndihmëse të sistemit të projektimit, si adapterë wireless, dongle, receiver ose aksesorë të tjerë të përputhshëm, duke shmangur nevojën për adaptorë shtesë të energjisë pranë projektorit. Sistemi duhet të ketë kontroll RS232 dhe RJ45 LAN Control për menaxhim teknik dhe komandim të centralizuar. Mbështetja për HDMI, HDBaseT, Fiber ose CAT6 Extender për transmetim sinjali në distanca të mëdha. Projektori duhet të ketë Video Scaler/Processor për përpunim të sinjalit dhe përshtatje sa më të mirë me ekranin e projektorit dhe formatet e ndryshme të videove.

Garancia minimale duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) vite për pajisjen dhe minimumi 30,000 orë funksionim për burimin e dritës laser.

2. Ekran Projektimi – sasia 1

Ekrani i projektimit duhet të jetë profesionale me kornizë fikse, pasi nevojitet sipërfaqe e qëndrueshme dhe pa lëvizje gjatë projekcionit. Përmasa aktive duhet të paktën 7200 × 4500 mm për sipërfaqe të madhe projektimi në sallë. Formatu 16:10 nevojitet për përputhje me projektorin dhe shfrytëzim të plotë të figurës.

Pranohet custom-made pra e kostumizuar në mënyrë që ekranin të përshtatet me dimensionet reale të ambientit. Duhet të ketë sistem tensionimi elastik në perimetër për të shmangur valëzimet në sipërfaqe.

Garancia minimale për ekranin manual të projektimit duhet të jetë jo më pak se 2 vite.

3. Mikser ndriçimi – sasia 1

Mikseri i ndriçimit duhet të jetë konsolë profesionale për pajisje DMX512, pasi ky është protokoll standard për ndriçimin skenik. Çdo fixturë duhet të mbështesë deri në 40 kanale kryesore, pasi robotët dhe pajisjet inteligjente kanë shumë funksione kontrolli. Duhet të ofroj mundësi

përditësimi i library-ve nga USB në mënyre që konsola të përshtatet me pajisje të ndryshme ndriçimi.

Të ketë opion Patch-imi për moving head dhe intelligent fixturës për lidhjen e robotëve të ndriçimit me konsolën. Të ofroj Patch-imi për dimmer me adresa të njëpasnjëshme, nevojitet për konfigurim më të shpejtë të ndriçuesve tradicionalë. Duhet të ketë adresimi automatik DMX për të shmangur gabimet gjatë konfigurimit. Mikseri duhet të ketë riadresimi pa humbur programimet ekzistuese gjë që është e nevojshme kur ndryshon konfigurimi i skenës.

Kontrolli i kanaleve duhet me wheel dhe slider për komandim praktik gjatë programimit. Kontrolli i dimmer-it duhet të jetë me slider, i nevojshëm për rregullim të shpejtë të intensitetit. Duhet të ketë Master slider për kontroll global të daljes së ndriçimit.

Konsola duhet të ruajë minimum 60 skena, pasi aktivitetet kërkojnë konfigurime të parapërgatitura. Mikseri duhet të ofroje dalje njëkohësisht e minimum 10 skenave është e nevojshme për kombinime ndriçimi gjatë shfaqjeve.

Duhet të ofroj mundësi ruajtje sipas fixture ose kanalit në mënyrë që programimet të jenë më të sakta. Të ketë opsione kopjimi, fshirje dhe rikthimi të skenave ekzistuese për programim më të shpejtë. Kërkohet të ketë opion ndryshimi të drejtimit të playback-ut i cili nevojitet për kontroll më artistik të efekteve. Duhet të ketë shape generator ose ekuivalent për krijim të shpejtë të efekteve dinamike.

Të ofroj opsione për efekte të lëvizjes për robotë, efektet e ngjyrave dhe efektet dinamike të dimmer/beam për ndriçim skenik kreativ. Mikseri duhet të ketë përzgjedhje individuale e fixture-ve për kontroll të saktë të secilës pajisje. Të ketë butona të dedikuar për attribute të cilat janë të nevojshëm për operim të shpejtë. Të ketë Ekran LCD për menu, konfigurime dhe monitorim.

Garancia minimale duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) vite për mikserin e ndriçimit.

4. Mikser audio – sasia 1

Mikseri duhet të jetë i tipit dixhital profesional, i përshtatshëm për përdorim në salla shfaqjesh, skena, evente live, ku kërkohet menaxhim i disa burimeve zanore njëkohësisht. Pajisja duhet të mundësojë miksim, përpunim dhe shpërndarje të sinjalit audio në mënyrë të kontrolluar dhe të qëndrueshme.

Mikseri duhet të ketë minimum 16 kanale hyrëse audio, pasi kërkohet lidhja e disa burimeve njëkohësisht, si mikrofona vokalë, mikrofona ambient, instrumente, kompjuter, player audio ose pajisje të tjera multimediale. Hyrjet duhet të jenë të balancuara, për të garantuar sinjal të pastër dhe reduktim të interferencave në kabllime.

Pajisja duhet të ketë ekran touch me madhësi të përshtatshme për kontroll profesional, minimumi 5”, pasi fonisti duhet të ketë akses të shpejtë në kanale, parametra audio, efekte, skena të ruajtura dhe konfigurime kryesore gjatë përdorimit.

Mikseri duhet të ketë fader-a fizikë elektrikë/motorikë, minimum 12 ose më shumë, pasi kontrolli fizik i volumit është i domosdoshëm në përdorime live ku ndryshimet bëhen në kohë reale. Fader-

at motorikë nevojiten për rikthim të saktë të niveleve gjatë kalimit midis konfigurimeve, layer-ave ose skenave të ruajtura.

Çdo kanal hyrës duhet të ketë përpunim DSP të integruar, duke përfshirë funksione si equalizer parametrik, filtra, noise gate, kompresor. Këto funksione kërkohen për pastrimin e sinjalit, kontrollin e zhurmave, përmirësimin e kuptueshmërisë së fjalës dhe përshtatjen e çdo burimi audio sipas karakteristikave të ambientit.

Mikseri duhet të ketë feedback suppressor të integruar pasi në përdorime me mikrofonat live ekziston rreziku i feedback-ut, sidomos kur mikrofonat përdoren pranë altoparlantëve ose monitorëve. Ky funksion ndihmon në ruajtjen e stabilitetit të sistemit dhe shmang ndërhyrjet e padëshiruara gjatë aktivitetit.

Mikseri duhet të mbështesë ruajtje dhe rikthim skenash / scene preset, pasi konfigurimet e ndryshme audio mund të kërkojnë nivele, mute, efekte dhe parametra të ndryshëm. Ky funksion ul gabimet gjatë përdorimit dhe lejon rikthim të shpejtë të konfigurimeve të mëparshme.

Duhet të mbështesë USB playback dhe USB recording ose zgjidhje ekuivalente, pasi shpesh nevojitet riprodhim i materialeve audio, muzikës, efekteve zanore ose regjistrim i provave dhe aktiviteteve. Mbështetja për funksione USB e bën pajisjen më fleksibël dhe zvogëlon nevojën për pajisje shtesë.

Duhet të mbështesë kontroll remote nga tablet ose pajisje ekuivalente, pasi tekniku mund të ketë nevojë të kontrollojë balancën e zërit nga pozicione të ndryshme të sallës. Ky funksion ndihmon në konfigurim më të saktë dhe në menaxhim më praktik gjatë provave ose eventeve.

Mikseri duhet të ketë funksion bllokimi të panelit ose mbrojtje ndaj përdorimit të paautorizuar, pasi në ambiente me përdorues të ndryshëm është e rëndësishme të shmangen ndryshimet aksidentale të konfigurimit.

Garancia minimale për mikserin e audios duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) vite.

5. Sistem profesional mikrofonash wireless – sasia 1 sistem me minimumi 4 mikrofonat

Sistemi duhet të përfshijë minimum 1 receiver shumëkanalësh dhe 4 mikrofonat dore wireless të karikueshëm, pasi nevojitet përdorim i disa folësve njëkohësisht. Minimum 4 kanale funksionale kërkohen që çdo mikrofon të punojë në kanal të veçantë. Teknologjia UHF me PLL ose ekuivalente nevojitet për transmetim të qëndrueshëm dhe më pak interferenca.

True diversity ose ekuivalent për marrje të sigurt të sinjalit pa ndërprerje. Minimum 200 kanale frekuence nevojiten për të zgjedhur frekuencën më të pastër në ambiente me shumë pajisje wireless. Gama e rregullimit rreth 60 MHz për fleksibilitet gjatë konfigurimit. Ekranet e receiver-it nevojiten për monitorim të frekuencës, kanalit dhe nivelit të sinjalit.

Kontrolli i veçantë i volumit për çdo kanal për menaxhim individual të mikrofonave. Daljet individuale audio me konektorë të balancuar nevojiten për lidhje të pavarur me mikser audio. Cilësia e transmetimit me raport të mirë sinjal/zhurmë dhe distorsion të ulët për zë të qartë. Dynamic range rreth 88 dB nevojitet për ruajtje të natyralitetit të zërit.

Raporti sinjal/zhurmë mbi 70 dB dhe distorsioni jo më shumë se rreth 1% kërkohen për riprodhim të pastër vokal. Distanca efektive deri rreth 150 m në hapësirë të hapur nevojitet për përdorim në salla të mëdha. Lidhjet RF të tipit BNC ose ekuivalente kërkohen për stabilitet dhe mundësi antenash të jashtme.

Bateria e karikueshme litium ose ekuivalente për përdorim të gjatë dhe ulje të kostove të baterive. Autonomia minimum 7 orë nevojitet për aktivitete të zgjatura dhe prova para shfaqjeve. Karikimi Type-C, dock ose ekuivalent për përdorim praktik. Ekranin ose treguesin në mikrofon nevojitet për kontroll të kanalit, frekuencës dhe baterisë.

Garancia minimale për sistemin profesional të mikrofonave wireless duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) vite.

6. Mikrofonat dinamikë - sasia 4

Mikrofoni duhet të jetë i tipit profesional dore për vokal, i përshtatshëm për përdorim në skenë, prezantime, evente live, ambiente koncertale, salla aktivitetesh dhe sisteme profesionale audio, pasi riprodhim i qartë i zërit dhe përdorim i qëndrueshëm në kushte të ndryshme operative.

Karakteristika polare duhet të jetë supercardioid me drejtim të ngushtuar, pasi nevojitet izolim më i mirë i zërit kryesor nga zhurmat anësore dhe reduktim i feedback-ut në përdorime skenike. Ky tip drejtimi është i rëndësishëm kur mikrofonin përdoret pranë altoparlantëve monitor, instrumenteve ose burimeve të tjera audio në skenë.

Përgjigjja në frekuencë duhet të jetë e përshtatshme për vokal, fjalim dhe përdorim live, me diapazon të gjerë audio që siguron qartësi, prezencë dhe natyralitet të zërit. Mikrofonin duhet të mbulojë të paktën zonën kryesore vokale, afërsisht nga 50 Hz deri në 16 kHz ose më gjerë, në mënyrë që të ruhet qartësia e zërit pa e bërë specififikimin tepër të ngurtë ose të lidhur drejtpërdrejt me një model të vetëm.

Ndjeshmëria duhet të jetë në nivel të përshtatshëm për mikrofon profesional vokal, rreth 2 mV/Pa ose ekuivalente, në mënyrë që zëri të transmetohet qartë në mikser ose sistem audio pa kërkuar përforsim të tepërt. Impedanca duhet të jetë e përshtatshme për lidhje me pajisje profesionale audio, me impedancë nominale në rangun e mikrofonave profesionale dhe me kërkesë për ngarkesë minimale të përshtatshme për miksera, preamplifier ose sisteme zëri. Lidhja audio duhet të jetë me konektor XLR 3-pin.

Garancia minimale për mikrofonat dinamikë duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit.

7. Stativa Mikrofonash - sasia 4

Stativi duhet të jetë profesional për mikrofon, i tipit floor tripod, i përshtatshëm për përdorim në skenë, prezantime, konferenca dhe ambiente audio profesionale. Duhet të ketë krah boom të rregullueshëm, pasi kërkohet pozicionim fleksibël i mikrofonit sipas përdoruesit.

Lartësia duhet të jetë e rregullueshme, minimum rreth 970 – 1680 mm, për t'u përshtatur me përdorim në këmbë ose në pozicione të ndryshme skenike. Krahu boom duhet të ketë gjatësi rreth 780 mm, për të mundësuar vendosje të saktë të mikrofonit pa lëvizur bazën e stativit.

Duhet të ketë mekanizëm për rregullim të shpejtë të lartësisë dhe këndit të boom-it, me sistem fiksimit të sigurt, në mënyrë që pozicionimi i mikrofonit të bëhet shpejt dhe pa lëvizje të padëshiruara gjatë përdorimit. Stativi duhet të jetë i palosshëm, me përmasa kompakte për transport dhe magazinim.

Garancia minimale për stativat e mikrofonave duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit.

8. Mikroфона Ambientale - sasia 4

Mikrofoni duhet të jetë i tipit profesional i varur, i përshtatshëm për instalim në tavan ose në strukturë mbajtëse, pasi duhet marrje e zërit nga lart në ambiente ku vendosja e mikrofonit direkt përpara folësit, korit ose skenës nuk është praktike ose estetike. Ky tip mikrofonit nevojitet për përdorim në kore, skena, salla teatri, salla prezantimi dhe instalime fikse audio ku kërkohet kapje e qartë e zërit pa penguar lëvizjen ose pamjen vizuale të ambientit.

Teknologjia e mikrofonit duhet të jetë electret condenser ose ekuivalente profesionale, pasi nevojitet ndjeshmëri e mirë dhe kapje natyrale e zërit edhe kur mikrofonit vendoset në distancë nga burimi. Karakteristika polare duhet të jetë supercardioid, cardioid me drejtim të ngushtuar, pasi nevojitet fokusim i marrjes së zërit dhe reduktim i zhurmave anësore në ambiente me reflektime ose me disa burime zanore njëkohësisht.

Përgjigjja në frekuencë duhet të jetë e përshtatshme për fjalim, vokal, kor dhe përdorim skenik, me diapazon të gjerë audio që siguron qartësi dhe kuptueshmëri të mirë të zërit. Diapazoni duhet të mbulojë afërsisht zonën kryesore vokale, rreth 100 Hz – 18 kHz, në mënyrë që të ruhet natyraliteti i zërit.

Ndjeshmëria duhet të jetë në nivel të përshtatshëm për mikrofon profesional të varur, rreth 4 mV/Pa në mënyrë që zëri të kapet qartë edhe kur mikrofonit nuk është shumë pranë folësit ose grupit vokal. Impedanca duhet të jetë e ulët dhe e përshtatshme për lidhje me pajisje profesionale audio, si mikserë, preamplifier ose sisteme qendrore të zërit.

Mikrofoni duhet të përballojë nivele të larta presioni zanor, minimum rreth 120 dB SPL ose më shumë, pasi në përdorime skenike, korale ose prezantime mund të ketë ndryshime të forta dinamike të zërit. Cilësia e sinjalit duhet të jetë e përshtatshme për riprodhim të pastër vokal, me zhurmë të ulët dhe shtrembërim minimal gjatë përdorimit normal.

Garancia minimale për mikrofonat ambientale duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) vite.

9. Robot ndriçimi Hybrid – sasia 6

Roboti duhet të jetë Moving Head Hybrid, pasi përdoret për efekte skenike në teatro, koncerte dhe ambiente multifunksionale. Duhet të ketë opsionet Beam, Spot dhe Wash ose ekuivalente në një trup të vetëm për fleksibilitet dhe ulje të nevojës për pajisje të veçanta. Burimi high-output duhet të ketë minimum 420W fuqi për ndriçim të fortë dhe efekt të dukshëm në skenë.

Fluksi minimal duhet të jetë të paktën 12,000 lumen në Beam dhe 14,000 lumen në Spot për intensitet të mjaftueshëm në distanca skenike në sallë. Intensiteti duhet të jetë të paktën 400,000

lux në Beam në distancë 5 m dhe 200,000 lux në Spot në distancë 5 m për efekte të forta rreze të nevojshme për shfaqjet teatrale.

Zoom-i për Beam nga rreth 1.6° deri 17° dhe për Spot nga rreth 3° deri 39° për ndryshim të gjërësisë së rrezes. Duhet të ofroj Zoom dhe fokus motorik për komandim nga konsola dmx pa ndërhyrje manuale.

Duhet të ketë minimumi 2 prizma, me konfigurime lineare/rrethore 6-facet dhe 8-facet ose ekuivalente, për efekte optike të shumëfishta

Të ketë Kontroll profesional DMX për integrim me mikserin e ndriçimit. Minimum 3 modalitete DMX kërkohen për fleksibilitet programimi. Kontrolli wireless ose menaxhimi ekuivalent është i dobishëm për instalime komplekse. Të ketë panel lokal dhe ekrani LCD kërkohen për konfigurim direkt në pajisje.

Garancia minimale për robotët e ndriçimit duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) vite.

10. Makineri bore – sasia 1

Makineria duhet të jetë profesionale për efekt bore artificiale, pasi përdoret në skena dhe evente. Fuqia minimum 1500W për prodhim të mjaftueshëm efekti në ambient të madh. Kontrolli DMX512, lokal me ekran dhe në distancë nevojitet për sinkronizim me ndriçimin dhe skenën.

Furnizimi 110–240 VAC, 50/60 Hz k për përputhje me rrjete të ndryshme elektrike. Kapaciteti minimal 50 m³ nevojitet që efekti të jetë i dukshëm në hapësirë skenike. Rregullimi i intensitetit nga paneli dhe DMX për të përshtatur sasinë e dëborës sipas skenës. Drejtimi vertikal ose i përmbysur për fleksibilitet në montim.

Paneli me ekran nevojitet për konfigurim të thjeshtë. Kontrolli DMX për integrim me sistemet e ndriçimit dhe efekteve. Telekomanda nevojitet për përdorim manual kur operatori nuk është pranë pajisjes. Certifikimet CE dhe RoHS ose ekuivalente nevojiten për siguri dhe përputhje me standarde teknike.

Garancia minimale për makinën e borës duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit.

11. Paketë për shpërndarje sinjali HDMI pa tela – sasia 1

Pajisja duhet të jetë paketë me 1 transmitter dhe 1 receiver, për transmetim i sinjalit HDMI pa kablllo nga burimi te ekrani ose projektori. Përdorimi për videoprojektorë, ekrane, salla konferencash dhe teatro justifikon nevojën për zgjidhje të thjeshtë dhe profesionale.

Transmitter-i duhet të ketë hyrje HDMI dhe receiver-i dalje HDMI, pasi kjo siguron lidhje direkte me burimet video dhe pajisjet e shfaqjes. HDMI loop-out në transmitter mundëson shfaqjen e sinjalit edhe lokalisht burimit. Rezolucioni minimal Full HD 1080P në frekuencë 60Hz nevojitet për figurë të qartë dhe lëvizje të rrjedhshme. Distanca e transmetimit duhet të jetë deri në 100 m në kushte line-of-sight, për përdorim në salla ku burimi dhe projektori ndodhen larg njëri-tjetrit.

Kompatibiliteti HDMI/HDCP, minimum HDCP 1.4 ose ekuivalent, nevojitet për përputhje me burime të ndryshme audio-video. Audio përmes HDMI me PCM 2.0 për transmetim të figurës dhe zërit në të njëjtin sistem. IR pass-back nevojitet për komandim të pajisjes burimore nga ana e receiver-it.

Garancia minimale duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit.

-Nisur nga mallrat objekt prokurimi, operatori ekonomik fitues do të kryejë furnizimin e këtyre pajisjeve edhe shërbime të lidhur me pajisjet, si instalimi, konfigurimi, vënia në punë e pajisjeve dhe trajnimi i stafit që do të përdorë pajisjet.

-Afati i lëvrimin të mallit do të jetë 45 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

- Vendi lëvrimin (destinacioni): Mallrat objekt prokurimi do të lëvrohen ne ambjentet e Autoritetit Kontraktor ekzaktësisht në “sallën 150” të Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” godina ArTurbina, rruga Sami Frashëri.

Për ngarkimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik, njësia e prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin.

NJESIA E PROKURIMIT